



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSPEKTORATI QENDROR

URDHËR

Nr. 12, datë 10/04/2015

PËR  
“MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR TË  
DREJTËN E INFORMIMIT NË INSPEKTORATIN QENDROR”

Në zbatim të ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”:

URDHËROJ:

1. Miratimin e planit të veprimit për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Formati i Programit të Transparencës për Inspektoratin Qendror të jëtë sipas Tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Formati i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve për Inspektoratin Qendror të jëtë sipas Tabelës nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri.
4. Formati i kërkesës për Informacion për Inspektoratin Qendror të jëtë sipas Formularit nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.
5. Koordinator për të drejtën e informimit i Inspektoratit Qendror caktohet Znj Arjola Hasi.
6. Ngarkohen Inspektorati Qendror për zbatimin e këtij urdhri.
7. Ky urdhër publikohet në Faqen Zyrtare të Inspektoratit Qendror, [www.inspektoratiqendror.gov.al](http://www.inspektoratiqendror.gov.al).

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM



## LIDHJE

# Programi i Transparencës për Inspektoratin Qendror

## I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Inspektoratin Qendror. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së Inspektoratit Qendror në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”(LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Inspektorati Qendror ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. Inspektorati Qendror do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Inspektoratit Qendrorë, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare [www.inspektoratiqendror.gov.al](http://www.inspektoratiqendror.gov.al) si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike, si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e Inspektoratit Qendror është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë, në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

## II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së Inspektoratit Qendror janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: Inspektoratit Qendror ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e Inspektoratit Qendror dhe përkatësisht: Ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” e Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
  - i plotë;
  - i saktë;
  - i përditësuar;
  - i thjeshtë në konsultim;
  - i kuptueshëm;
  - lehtësisht i aksesueshëm;
  - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të Inspektoratit Qendror.

### III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Inspektoratit Qendror vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [www.inspektoratiqendror.gov.al](http://www.inspektoratiqendror.gov.al) dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;
- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitim të kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit;
- Informacion për procedurat e prokurimit, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, që kryhen për llogari të Inspektoratit Qendror, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

- Informacion për shërbimet që Inspektoratit Qendror i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit dhe të procedurave për t'i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga Inspektoratit Qendror;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e Inspektoratit Qendror, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të Inspektoratit Qendror, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor Inspektoratit Qendror për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- Inspektorati Qendror, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga Inspektorati Qendror.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

## Tabela nr. 1

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore LDI	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Sektori Përgjegjës për Përgatitjen e Materialit apo disponimin e tij.
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 7/1/a/d	Vendim miratimi. Skemë e strukturës. Struktura e pagave. <u>pagat e funksionarëve</u> Tabelë e funksioneve. detyrave dhe kompetencave të drejtorëve/ive, arsimit, kualifikimet e drejtuesve.	Pas botimit në fl/zyrtare.  Përditësohet pas çdo akt emërimi.	Në faqen zyrtare në menunë "Autoriteti (IQ)"	Sektori i burimeve njerëzore.
Akte ndërkombëtare ligje; akte nën ligjore; dokument politikash; dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Konventa  <u>Ligje</u>  <u>Akte nënligjore</u>	Pas botimit në fl/zyrtare	Në faqen zyrtare në menunë "Legjislacioni"	Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore.
	Neni 16/e i ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011	<u>Kodi i sjelljes Strategji</u>  <u>Raport vjetor</u>	Pas miratimit të urdhrat nga Inspektori i Përgjithshëm.  Menjëherë pas dorëzimit në KM	Në faqen zyrtare në menunë "Autoriteti (IQ)"  Në faqen zyrtare në menunë "Autoriteti (IQ)"	
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Neni 7/1/c/g	<u>Format kërkesë</u> <u>Format ankese</u> <u>Shpjeguese</u> <u>Adresë postare:</u> <u>Adresë e-mail:</u> info@insq.gov.al	Pas miratimit të Programit të transparencës. Menjëherë në rast ndryshimesh	Në faqen zyrtare në menunë "E drejta për informim"	Drejtoria e Mbikëqyrjes dhe e inspektimit.

Të dhëna për vëndndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1/ç	Shpjeguese për koordinatorin	Pas miratimit të urdhrat të caktimit të Koordinatorit.	Në faqen zyrtare në menunë " <u>Koordinatori</u> "	Specialisti i DM.
Përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	Neni 7/1/d	VKM Parashikimet ligjore në nenin Neni 16 i ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 Neni 24 i ligjit nr. 119/2014.	Menjëherë pas botimit në fl /zyrtare.  E përhershme	Në faqen zyrtare në menunë " <u>Autoriteti/Rreth nesh</u> "	DUMK
Mekanizmat monitorues; Raporte auditit; Dokumentet me tregues performance;	Neni 7/1/dh	Raporte monitorimi dhe auditivi.(KLSH & MF)	Menjëherë pas depozitimit në IQ ose publikimit në faqen zyrtare të monitoruesve.	Në faqen zyrtare në menunë " <u>Publikime</u> ".	DM
Buxheti	Neni 7/1/e	KM Buxheti	Menjëherë pas depozitimit në IQ	" <u>Autoriteti</u> "	DM
Informacion për procedurat e prokurimit.	Neni 7/1/ë	Raporte Rregjistri	Çdo tre mujor. Menjëherë pas dërgimit në APP.	Në faqen zyrtare në menunë " <u>Publikime</u> "	DM
Shërbimet e Inspektoratit Qendror.	Neni 7/1/f	Rregjistri i njoftimeve	Përditësohet periodikisht.	Në faqen zyrtare në menunë " <u>Sistemi i inspektimit</u> " Me kufizime të masave të sigurisë të përdorura nga kontrolluesit	DM
		Fatura arkëtimi	E përhershme.	Në faqen zyrtare në menunë " <u>Publikime</u> "	

Paraqitja e mendimeve në hartimin e p/akteve, etj.	Neni 7/1/gj	p/akt ligjor dhe nënligjor p/strategji	Pas nënshkrimit të relacionit shoqërues.	Në faqen zyrtare në menunë "Sistemi i inspektimit", "E Drejta për informim" "Njoftimi për Konsultim Publik"	DUMK
Mbajtja e dokumentacionit nga Inspektorati Qendror.	Neni 7/1/h	Tabelë	Pas miratimit të urdhrit të Komisionit të Ekspertizës.	Në faqen zyrtare në menunë "Publikime"	DM/specialisti i Arkiv - Protokollit
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të ligjit nr. 119/2014	Neni 7/1/i	Tabelë	Pas miratimit të programit të transparencës.	Në faqen zyrtare në menunë "Programi i Transparencës" <b>Me kufizime të identitetit të ankuesit.</b>	Koordinatori i IQ
Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Neni 7/1/k	Formulari i njoftimit  Vendime Rekomandime Urdhra  Manuale Udhëzues Opinione	Pas miratimit nga Inspektori i Përgjithshëm.	Në faqen zyrtare në menunë "Sistemi i inspektimit"  Në menunë / Mbrojtja e të dhënave "Inspektime" <b>Me kufizime të subjekteve të të dhënave personale në vendime dhe rekomandime</b>  Në menunë / E drejta për informim "Legjislati ORI" <b>Me kufizime të</b>	DUMK



		<p>Nëpunës civil (vende vakante)</p> <p>Ankesa Kërkesa</p> <p>Politika e privatësisë</p> <p>Materiale ndërgjegjësuese dhe evente</p>	<p>Pas çdo krijimi të vendit vakant.</p> <p>Pas miratimit nga inspektori i Përgjithshëm.</p>	<p><i>subjekteve të të dhënave personale në vendime dhe rekomandime</i></p> <p>Në menunë "Autoriteti"</p> <p>Në faqen zyrtare në menunë "Ankesa"</p> <p>Në faqen zyrtare "Kreu"</p> <p>Në faqen zyrtare në menunë "Publikime"</p>	<p>DM</p>
<p>Informacione të tjera të dobishme.</p>	<p>Neni 16/e i ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011</p>				

## **V. PUBLIKIMI**

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Inspektorati Qendror vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [www.inspektoratiqendror.gov.al](http://www.inspektoratiqendror.gov.al) dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar "*Programi i Transparencës*".

## **VI. MONITORIMI**

Inspektori i Përgjithshëm monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, në Inspektoratin Qendror.

# Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

## Tabela nr. 2

№. Rëndor	Data e regjistrit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Statusi i kërkesës	Tarifa
01		.....			
02		.....			
03		.....			
04		.....			

## **Koordinatori**

### **Koordinatori për të drejtën e informimit i Inspektoratit Qendror**

**Emër Mbiemër: Arjola Hasi**

Email: info@insq.gov.al

Nr. Jeshil: 0000000000000000

Tel: 042 229765

Adresa: Rruga "Frosina Plaku, nr. 58, Godina e Observatorit, Kati 0, Tiranë

Orari: E Hënë - E Enjte 08:00 - 16:30

E Premte 08:00 - 14:00

## KËRKESË PËR INFORMACION

<b>Emër Mbiemër:</b> Z./Znj. _____	<b>Adresa postare:</b> _____ <b>Adresa elektronike:</b> _____ <b>Nr. Tel:</b> _____	<b>Data:</b> _ / _ /201_ <b>Nënshkrimi:</b> _____
--	--	--

*(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër, nënshkrim dhe dokument identifikimi të skanuar)*

<b>Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar</b>
_____ _____ _____ _____ _____ _____ _____ _____

<b>Të tjera të dhëna</b>
_____ _____ _____

<b>Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:</b>
_____ _____ _____

**Vetëm për përdorim zyrtar**

Data e marrjes: ___ / ___ /201__	Numri rendor i kërkesës:	Komente: _____ _____ _____
----------------------------------	--------------------------	----------------------------------

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e Inspektoratit Qendror, apo, nëpërmjet faqes zyrtare të Inspektoratit Qendror [www.inspektoratiqendror.gov.al](http://www.inspektoratiqendror.gov.al).
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të Inspektoratit Qendror që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Formularin e ankesës do ta gjeni pranë atij institucioni, si dhe në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [www.idp.al](http://www.idp.al)